



Bashkia Belsh është pjesë e Projektit Bashkitë për në Evropë, një nismë e Bashkimit të Evropian, e cila synon të rrisë kapacitetet e Njësive të Qeverisjes Vendore në Shqipëri në kuadër të procesit të integrimit evropian të vendit, duke ngritur në secilën bashki një zyrë të BE. Në bashkinë Belsh është ngritur në Janar 2018 (sipas zyrës së burimeve njerëzore) dhe me 20/09/2018 në zbatim të MKM nr.450. dt 26/07/2018 u ngrit Njësia për Koordinimin e Integrimit Evropian dhe Ndihmës Huaj.

Objektivi i përgjithshëm: *Forcimi i kapaciteteve qeverisëse të bashkive në lidhje me çështjet e BE-së, si dhe informimi i qytetarëve dhe administratave lokale në Shqipëri, rreth informacionit në lidhje me BE-në, politikën dhe programet e saj.*

Për përmbushjen e këtij qëllimi janë organizuar disa takime informuese dhe aktivitete me përfaqësues të ndryshëm të komunitetit si nxënës shkollash, fermerë, përfaqësues të biznesit dhe OSHC si edhe me punonjësit e administratës lokale.